

FONDACIONI "PËRKRAHJE PËR MBROJTJEN JURIDIKE TË HASHIM THAÇIT"  
KËRKON NGA SHTETI MBËSHTETJE FINANCIARE SHTESË PËR MBROJTJEN  
E LIDERËVE TË UÇK-SË NË HAGË Faqje 4

Shefi i CIA-s viziton Kosovën

Faqje 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)

**AWR ABBRUCH GMBH**  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## OPINION

FEJTON I "GEORGE F. KENAN:  
MEMOARE 1925 - 1950" (6)

**BASHKIMI SOVJETIK KISHTE  
PLANE PËR SHKATËRRIMIN E  
PRESTIGJIT DHE FUQISË SË  
SHBA-së! F. 10**



Shkruan:  
Prof. dr. Agim ZOGAJ

## AKTUALE



**HARADINAJ, KURTIT: RINIA, GRATË  
DHE MËRGATA S'DO TË JENË MË TË  
NËPËRKËMBUR F. 3**

**FILLON DIGJITALIZIMI I PROCESIT  
ZGJEDHOR NË KOSOVË, KOZ-ja  
PRANON SOFTUER NGA OSBE-ja F. 7**


**QEVERIA KËRKON HEQJEN  
E MENJËHERSHME  
TË MASAVE TË BE-së F. 7**

## EKONOMI



**ABDIKHIKU: MË 9 SHKURT  
MARRIN FUND VONESAT  
INFRASTRUKTURORE, HISTORIA  
RRUGORE DO TË KOMPLETOHET  
BRENDA NJË MANDATI F. 8**

**BQK-ja: EKONOMIA E KOSOVËS  
PRITET TË RRITET 3.9 PËR QIND  
GJATË KËTIJ VITI F. 8**



Ekipi mbrojtës i ish-presidentit Hashim Thaci, nëpërmjet një letre drejtar kryeparlamentarit Glauk Konjufca, kryeministrit Albin Kurti dhe ministres Albulena Haxhiut, ka kërkuar mbështetje financiare shtesë për mbrojtjen e Thaci. Bordi i

Fondacionit "Përkrahje për mbrojtjen juridike të Hashim Thaci" ka bërë me dije se në mungesë të mjeteve financiare, ish-presidentit i është larguar një prej avokatëve kryesorë, "por edhe aktualisht avokati kryesor i angazhuar ka paralajmëruar se do të

mund të largohet në periudhën e ardhshme, respektivisht nga fundi i këtij muajit". Në këtë drejtim, mbrojtja e Thaci ka vlerësuar se ndarja e mjeteve financiare të kërkuarë i shërben drejtësisë dhe mbrojtjes së kauzës së drejtë të luftës së UÇK-së

## VESELIT I LARGOHET AVOKATI KRYESOR, KRITIKOHEN INSTITUCIONET PËR MOSMBËSHTETJEN E LIDERËVE TË UÇK-së F. 5

**RENOVA**  
PUTZ

Magedoni Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mot: +377 44 501 289

E-mail: renova@m.t.net.mk

**NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE**  
**PRINCESHA GROUP SH.P.K.**

INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: info@sigma-ks.net / www.sigma-ks.net

**INFINITY**  
Digital Agency

Endrit Shaqiri  
+383 44 685 122

Internet Website,  
Marketing...

## Macroni do ta vizitojë Serbinë në fund të gushtit

**BEograd, 22 Gusht** - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, do të realizojë një vizitë zyrtare në Serbi më 29 dhe 30 gusht, kështu është thënë në një njoftim të publikuar në uebfaqen e presidentit serb Aleksandër Vuçiq.

Vizita e Macronit në Beograd do të realizohet më pak se pesë muaj pasi ai e priti në Paris homologun e tij serb, Vuçiq.

Kjo do të jetë vizita e dytë e presidentit francez në Serbi në pesë vitet e fundit, teksha dy shtetet po forcojnë raportet e tyre, veçmës në fushën e ekonomisë.

Gjatë pjesëmarrjes në ceremoninë hapëse të Lojërave Olimpike Verore, që është mbajtur në Paris, Vuçiqi muajin e kaluar ka thënë se vizita e



Macronit në Serbi pritet të realizohet në fillim të shtatorit. Të dy burrështetasit në deklaratat e tyre publike kanë sugjeruar se një prej temave të takimit do të jetë

blerja nga Serbia e avionëve luftarakë francezë, "Rafale". Në shkurt të vitit 2023 Vuçiqi u ka thënë gazetarëve se blerja e avionëve Rafale do të jetë blerja

më e madhe nga buxheti i ushtrisë serbe, "në vlerë prej 3 miliardë eurosh".

Çështjet ushtarake do të janë pjesë e bisedimeve, ka konfirmuar Macroni në një konferencë për medie më 18 korrik gjatë Samitit të Komunitetit Politik Evropian, që u mbajt në Mbretërinë e Bashkuar.

I pyetur për statusin e kontratës për shijen e avionëve francezë te Serbia, Macroni ka thënë se ai do ta vizitojë Serbinë në javët apo muajt në vijim "për t'i finalizuar negociatat që janë subjekt i negociatave teknike, financiare dhe politike mes dy shteteve".

Një tjetër çështje për të cilën Macroni dha Vuçiqi do të bisedojnë do të jetë edhe

Kosova. Gjatë një bisede telefonike të realizuar në mesin e qershorit, Vuçiqi i ka thënë Macronit se është e rëndësishme që çështja e zgjidhjes të mosmarrëveshjeve me Kosovën të mbetet lart në agjendën e Bashkimit Evropian, teksha i kërkoi mbështetje udhëheqësit francez për këtë çështje.

Të dyja shtetet i kanë përkruar raportet mes tyre si "të forta dhe miqësore" dhe vitin e kaluar takimet e nivelit të lartë u shtuan. Përveç vizitës së Vuçiqit në Pallatin Elize në prill, presidenti serb është takuar me Macronin edhe në forume ndërkombëtare, por edhe gjatë ceremonisë hapëse të Lojërave Olimpike.

## ShBA-ja dërgon aeroplanmbajtësen e dytë në Lindjen e Mesme

**UASHINGTON, 22 GUSHT** - Grupi sulmues i aeroplanmbajtës "USS Abraham Lincoln" ka mbërritur në Lindjen e Mesme, duke iu bashkuar transportuesit "USS Theodore Roosevelt", i cili është vendosur në rajon prej disa kohësh.

Sipas komandës qendrore të ShBA-së, "USS Abraham Lincoln" mban avioni luftarakë "F-35" e "F-18" dhe është e shoqëruar nga një skuadron shkatërruesh.

Pentagoni ka dërguar grupin transportues në rajon në fillim të këtij muaji pas vrasjes së shefit të byrosë politike të Hamasit, Ismail Haniyeh në Teheran dhe operativit të lartë të Hezbollahut, Fuad Shukr në Bejrut.

Izraeli ka marrë përgjegjësinë për

sulmin që vrau Shukr, por as nuk e ka konfirmuar dhe as mohuar përfshirjen në vdekjen e Haniyeh. Teherani, megjithatë, ka kërcënuar Izraelin me "ndëshkim të ashpër", ndërsa shteti hebre po përgatitet për sulme ndërkufitare. "Koha është në favorin tonë dhe periudha e pritjes për këtë përgjigje mund të jetë e gjatë", ka thënë Alimohammad Naini, zëdhënës i Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike.

Forcat e Mbrojtjes të Izraelit, nga ana tjetër, kanë kërcënuar me më shumë sulme ushtarake kundër Hezbollahut në Liban, duke shkaktuar frikën e një pushtimi të plotë, ndaj prania e luftanijeve amerikane pasqyron frikën e një përshkallëzimi në Lindjen e



Mesme.

ShBA-ja dhe Izraeli janë të shqetësuara se Irani mund të

kryejë një sulm të kombinuar ndaj shtetit hebre, duke punuar së bashku me grupe të ndryshme

pro-palestinez, duke përfshirë Hezbollahun dhe rebelët Houthi Jemenit.

## Presidenti çek: Ka disa opsione për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë



**PRAGË, 22 GUSHT** - Presidenti i Republikës Çeke, Petr Pavel, ka thënë se lufta në Ukrainë do të vazhdojë derisa të ketë forcë të mjaftueshme për t'i bindur të dyja palët për pamundësinë e arritjes së qëllimeve politike përmes mjeteve ushtarake dhe se ka disa opsione për t'i dhënë fund konfliktit të Rusisë kundër Ukrainës.

"Kjo mund të ndodhë këtë vit, por mund të ndodhë vitin e

ardhshëm, ose ndoshta pas shumë vitesh", ka thënë Pavel në podkastin "PoliTalk".

Në të njëjtën kohë ai nuk ka përjashtuar mundësinë që konflikti të kalojë nga një fazë e nxehëtë në një fazë të ngrirë, e cila, siç ka thënë ai, "mund të zgjasë me vite".

"Besoj se në pak vite të dyja palët do të kuptojnë se është e pamundur të shkohet më tej dhe negociatat do të zhvillohen. Jo vetëm Shtetet e

Bashkuara të Amerikës, por edhe Kina, duhet të jepin një kontribut të rëndësishëm për këtë dhe t'i inkurajojnë të dyja vendet drejt negociatave diplomatike", ka thënë lideri çek.

Pavel ka vlerësuar se edhe pse Bashkimi Evropian është një fuqi e madhe ekonomike dhe politike, nevojitet një qasje e unifikuar që të përfshijë ShBA-në dhe të gjitha vendet demokratike të botës.

## Ukraina: Rusia ka humbur mbi 600 mijë trupa që nga fillimi i luftës

**KIEV, 22 GUSHT** - Ukraina ka thënë se Rusia tanë ka humbur më shumë se 600 mijë trupa që nga

fillimi i pushtimit të saj në shkallë të plotë. Në një përditësim nga shtabi i përgjithshëm i

Forcave të Armatosura të Ukrainës, bilanci përfshin 604 mijë e 140 personel, mbi 600

helikopterë dhe avionë, mbi 16 mijë automjete të blinduara dhe mbi 8 500 tanke.



## Haradinaj, Kurtit: Rinia, gratë dhe mërgata s'do të jenë më të nëpërkëmbur

**PRISHTINË, 22 GUSHT (ER)** - Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka kritikuar kryeministri Albin Kurti i cili ka thënë se fitoren e 14 shkurtit ia kanë dhënë rinia, gratë dhe diasporë.

Haradinaj ka thënë se me qeverisjen katervjeçare të Vetëvendosjes të gjitha këto grupe janë zhgënjer.

"Mashtimi s'kalon. Nuk ka tallje më të madhe sesa të thuash se fitoren ma kanë dhënë rinia, gratë dhe diaspora e të llogaritësh prapë në mbështetjen e tyre. Të rinisë e cila kurri nuk ka qenë në gjendje më të pashpresë. Të rinisë e cila në përmasa të frikshme po e braktis vendin. Të rinisë e cila as nuk ka punë, as të hyra, as arsim cilësor e as

shpresë se kjo qeveri e ky kryeministër, mund ta ndryshojnë gjendjen për ta. Nuk ka fyerje më të madhe sesa të thuash e kemi mbështetjen e grave, kur pozita e gruas e përfshirja e saj në jetën publike është pothuaj e papërfillshme. Ku dhuna ndaj grave, edhe si rezultat i një depresioni kolektiv të shkaktuar nga kjo qeveri, po merr përmasa

shqetësuese", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ai ka thënë se kjo gjendje do të ndryshojë pas 9 shkurtit të vitit 2025. "Të diasporës që i janë mbyllur të gjitha dyert për të investuar, për të kontribuar e për t'u bërë pjesë e vendimtarës në vendin e tyre. Dhe do të ndryshojë kjo gjendje. Rinia, gratë e mërgata nuk do të jenë kategori tē



nëpërkëmbura, por do t'i rikthejmë në vendin që u takon", ka shkruar Haradinaj.

## Shefi i CIA-s viziton Kosovën

**PRISHTINË, 22 GUSHT** - Shefi i Agjencisë Qendrore amerikane të Intelligencës (CIA), William Burns, ka qëndruar të enjten për një vizitë në Kosovë.

Burns është takuar me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, në kryeqytet. Në takim ishte i pranishëm edhe drejtori i Agjencisë së Kosovës për Intelligencë (AKI), Petrit Ajeti, merr vesh "Radio Evropa e Lirë". Askush nga palët nuk është deklaruar rreth këtij takimi deri tanë. Vizita e tij në Kosovë vjen pasi zyrtari i lartë i inteligençës amerikane qëndroi në Bosnjë-Hercegovinë dhe Serbi.

Paraprakisht, Ambasada Amerikane në Prishtinë nuk ka konfirmuar vizitën e Burnsit në Kosovë. "Radio Evropa e Lirë" nuk ka marrë konfirmim as nga Presidenca e Kosovës, as nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Por, avioni i ushtrisë amerikane, me të cilin besohet se ka udhëtar shefi i CIA-s në rajon, ishte parë mesditën e së enjtes në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Aeroplani i ushtrisë amerikane ishte ndalur para zonës "VIP" të aeroportit.

Me këtë avion besohet se Burns ka udhëtar nga Sarajeva në Beograd, ndërsa ky aeroplan ka udhëtar nga Beogradit drejt Bullgarisë, Maqedonisë së Veriut dhe në fund Kosovës, sipas uebfaqes për gjurmimin e futurimeve, "Flightradar".

Në Bosnjë-Hercegovinë më 20 gusht, Burns është takuar me homologët e tij nga sektori i inteligençës, me anëtarët e Presidencës së këtij shteti dhe me ministrin e Jashtëm të Bosnjës.

Siq ka thënë për "REL"-in një



zyrtar i qeverisë amerikane, i cili ka folur në kushte anonimiteti, arsyja e vizitës së shefit të CIA-s në Sarajevë, ndër të tjera, ishte edhe për shkak të retorikës dhe veprimeve shqetësuese separatiste të presidentit prorus të entitetit të Republikës Sérpska, Millorad Dodik dhe qeverisë së këtij entiteti.

Ndërsa që më 21 gusht ka shkuar në Beograd, por kjo vizitë nuk është konfirmuar dhe as mohuar nga zyrtarët në Serbi dhe Shtetet e Bashkuara.

Vizita e Burnsit në rajon vjen në kohën kur ambasadori american në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka

thënë se shteti i tij është sfiduar në disa aspekte nga Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti.

ShBA-ja dhe shtete të tjera të bashkësës ndërkombëtare kanë kritikuar disa vendime dhe veprime të ndërrmarra së fundi nga qeveria e Kurtit, që janë konsideruar "të njëanshme" dhe "të pakoordinuara".

Departamenti Amerikan i Shtetit i ka kërkuar qeverisë Kurti që të rikthehet në "angazhim konstruktiv dhe të ngushtë" me Uashingtonin, Bashkimin Evropian dhe NATO-n, teksa Uashingtoni, po ashtu, po

kërkon që institucionet e Kosovës të mos e hapin për qarkullim urën mbi lumin Ibër, duke u thirrur në shqetësime të sigurisë.

Vizita e shefit të CIA-s në rajonin e Ballkanit Perëndimor, për ish-komandantin e Forcave të Sigurisë së Kosovës, Kadri Kastrati, mund të jetë për shkak se "Rusia po bën një luftë hibride në Ballkanin Perëndimor".

"Rreziku më i madh i konfliktit është në Bosnjë-Hercegovinë, përmes Republikës Sérpska, dhe në veri të Kosovës. Vizita e zyrtarëve të lartë në këtë rajon tregon se ata kanë informacione

të mjaftueshme për përpjekjet ruse - përmes satelitit të saj, Serbisë - se kjo pjesë e Evropës është në rrezik të një konflikti të mundshëm... dhe është e sigurt që kanë ardhur këtu për t'i dhënë rekomandimet e tyre", ka thënë Kastrati.

Burns është ish-ambasador i ShBA-së në Rusi. Ai është një figurë qendrore në administratën e presidentit amerikan Joe Biden pasi ai është edhe anëtar i kabinetit presidencial të Shtëpisë së Bardhë. Ai është emëruar nga presidenti Biden në postin e drejtorit të CIA-s në janar të vitit 2021.

## Qeveria kërkon heqjen e menjëherës së masave të BE-së

**PRISHTINË, 22 GUSHT** - Qeveria e Kosovës ka vlerësuar se mbajta në fuqi e masave ndëshkuese të Bashkimit Evropian (BE) ndaj Kosovës me gjithë rekomandimin pozitiv të përfaqësuesit të lartë të BE-së, Josep Borrell, është e pakuptimtë.

Këshilltari i zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi, Klisman Kadiu, ka thënë se masat duhet të hiqen

menjëherë dhe në mënyrë të plotë. "Masat kanë qenë të padrejta prej ditës së parë. Mbajta ende në fuqi e këtyre masave përkundër rekomandimit pozitiv nga përfaqësuesi i lartë i BE-së, z. Josep Borrell, tashmë është e pakuptimtë. Ishte vetë letra e Borrellit më 3 qershor 2023 ajo që vendosi kushtet përvendosjen e masave ndaj Kosovës, që pasoi me

marrëveshjen e Bratislavës, dhe vetë përfaqësuesi i lartë Borrell, i cili i ka propozuar fillimisht ato, ka më shumë se një muaj që ka konstatuar se të gjitha kushtet janë përbushur dhe masat duhet të hiqen. Meqë është konstatuar përbushja e kushteve nuk ka nevojë as për heqje graduale, e hiç më pak për mbajtjen e tyre, por duhet largimi i plotë dhe i njëanshëm i masave", ka thënë

Kadiu për "RTV21". Ditet më parë zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka thënë se diskutimet e shteteve anëtare të BE-së në Këshill për raportin e përfaqësuesit të lartë, për përbushjen e kërkesave të BE-së nga Kosova janë duke vazhduar, teksha u ka bërë thirje autoriteteve të Kosovës të përbahen nga hapat e njëanshëm dhe të pakoordinuar.



Masat ndaj Kosovës janë vënë pas tensioneve në pjesën veriore të Kosovës në kohën kur kryetarët e zgjedhur shqiptarë në katër komunat në veri u dërguan me mbështetjen e Policisë së Kosovës në zyrat e tyre.



FONDACIONI "PËRKRAHJE PËR MBROJTJEN JURIDIKE TË HASHIM THAÇIT" KËRKON NGA SHTETI  
MBËSHTETJE FINANCIARE SHTESË PËR MBROJTJEN E LIDERËVE TË UÇK-SË NË HAGË

## Ekipi mbrojtës i Thaçit, letër Konjufcës, Kurtit dhe Haxhiut: Urgjente dhe e domosdoshme mbështetje financiare shtesë

Ekipi mbrojtës i ish-presidentit Hashim Thaçi, nëpërmjet një letre drejtuar kryeparlamentarit Glauk Konjufca, kryeministrit Albin Kurti dhe ministres Albulena Haxhiu, ka kërkuar mbështetje financiare shtesë për mbrojtjen e Thaçit. Bordi i Fondacionit "Përkrahje për mbrojtjen juridike të Hashim Thaçi" ka bërë me dije se në mungesë të mjeteve financiare, ish-presidentit i eshtë larguar një prej avokatëve kryesorë, "por edhe aktualisht avokati kryesor i angazhuar ka paralajmëruar se do të mund të largohet në periudhën e ardhshme, respektivisht nga fundi i këtij muaji". Në këtë drejtim, mbrojtja e Thaçit ka vlerësuar se ndarja e mjeteve financiare të kërkua e shërbën drejtësisë dhe mbrojtjes së kauzës së drejtë të luftës së UÇK-së

në zëvendësimin e tij me një avokat jetët, të cilat do t'i duhej kohë e konsiderueshme për t'u njohtur me rrëthanat e rastit dhe procedurën gjyqësore katërvjeçare që eshtë duke u zhvilluar. Prandaj, si fondacion, të gjindur në rrëthana të pamundësisë për t'i ofruar mbështetje financiare për nevojat financiare ekipit mbrojtës të z. Thaçi, e vlerësojmë urgjente dhe të domosdoshme një mbështetje financiare shtesë, në mënyrë që të sigurohet vijimi i

mbrojtjes efektive për ish-presidentin Thaçi në procesin gjyqësor ndaj tij. Nga ana tjetër, fondacioni, përkundër se eshtë themeluar pikërisht përfshirë ofruar një burim alternativ të mbështetjes financiare me qëllim të lehtësimit të barriës financiare të buxhetit publik përkufizuar me këtë proces, nuk ka arritur të sigurojë fonde të mjaftueshme të cilat do të bënin të panevojshëm dhe të pa objekt këtë kërkesë", eshtë thënë në kërkesën e

Fondacionit "Përkrahje për mbrojtjen juridike të Hashim Thaçi".

Fondacioni për ish-presidentin Hashim Thaçi ka vlerësuar se përmes mbështetjes financiare shtesë nga institucionet kompetente të Republikës së Kosovës do të mundësohet edhe qasja efektive në drejtësi, respektivisht në garancitë që derivojnë prej saj, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen edhe në të drejtën për t'u mbrojtur nga mbrojtës të zgjedhur me vullnet të lirë, pa iu nënshtruar asnjë kufizimi. Po ashtu, sipas këtij fondacioni, kjo do të mundëson edhe realizimin efektiv të të drejtës për një proces të irregull (nga nen 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe nen 31 i Kushtetutës), element konstituiv i së cilës eshtë edhe zbatimi i parimit të "barazisë së armëve", që nënkupton vënien në ekuilibër të drejtë të palëve në procedurë.

"Pamundësia financiare për ta mbrojtur në mënyrë efikase cështjen para Dhomave të Specializuara, jo vetëm për ish-presidentin Thaçi, por edhe cilindor person të akuzuar, e vendos në pozitë të pabarabartë në raport me Zyrën e Prokurorit të Specializuar, e cila ka buxhet pakrahasimisht më të madh për kryerjen e funksioneve të saj. Duke marrë përfshirë edhe natyrën e akuzave me të cilat përballen ish-kërët e UÇK-së, përfshirë z. Thaçi, pa paragjikuar procesin gjyqësor i cili eshtë duke u zhvilluar aktualisht, përtëj çdo dyshimi, sipas Fondacionit "Përkrahje për mbrojtjen juridike të

**EPOKA**  
**ERE**

Lirim GECI

**PRISHTINË, 22 GUSHT** - Një kërkesë zyrtare për rritjen e fondeve për nevojat e mbrojtjes juridike të kërkeve të UÇK-së, kryeparlamentarit Glauk Konjufca, kryeministrit Albin Kurti dhe ministres Albulena Haxhiu, iu ka shkuar më 12 gusht 2024 nga Fondacioni "Përkrahje për mbrojtjen juridike të Hashim Thaçi". Bordi i këtij fondacioni përmes kësaj letre u ka shkruar kërkeve të institucioneve se "vendosja e kufizimeve të shpenzimeve për qëllime të mbrojtjes juridike që eshtë bërë përmes Udhëzimit administrativ MD-nr. 01/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ MD - nr. 08/2022 për

mbrojtjen juridike të personave të akuzuar potencialë për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore nga Dhomat e Specializuara, ekipin mbrojtës të ish-presidentit Thaçi e ka vënë në situatë të pamundësisë objektive për ta kryer funksionin e tij", eshtë në kërkesën e Fondacionit "Përkrahje për mbrojtjen juridike të Hashim Thaçi".

Në mungesë të mjeteve financiare, fondacioni ka treguar se i eshtë larguar një prej avokatëve kryesorë, "por edhe aktualisht avokati kryesor i angazhuar ka paralajmëruar se do të mund të largohet në periudhën e ardhshme, respektivisht nga fundi i këtij muaji". Në këtë mënyrë kjo do të kishte për pasojë jo vetëm penalizimin e ekipit mbrojtës të z. Thaçi, por do ta pezullonte apo shtyne vetë procesin gjyqësor edhe përsë paku gjashtë muaj shtesë, deri

**Për:**  
- Z. Glauk Konjufca, kryetar  
Kuvendi i Republikës së Kosovës  
- Z. Albin Kurti, Kryeministër  
Qeveria e Republikës së Kosovës  
- Zn. Albulena Haxhiu, Ministre  
Ministria e Drejtësisë

**Nga:**  
Ismail Syla, Kryetar i Bordit të Fondacionit "Përkrahje për mbrojtjen juridike të Hashim Thaçi"

**Lëndë:**  
Kërkesë për mbështetje financiare për nevojat e mbrojtjes juridike të ish-Presidentit të Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi

Inderuar Kryetar i Kuvendit z. Konjufca,

Inderuar kryeministër z. Kurti,

Inderuar ministre znj. Haxhiu,

Duke shprehur konsiderat për Ju dhe funksionet institucionale që i ushtron, përmes kësaj letre, në emr të Fondacionit "Përkrahje për mbrojtjen juridike të Hashim Thaçi", po ju shkruajmë për t'ju vënë në dijeni me sfidat e mëdha financiare nëpër të cilat po kalon ekipi mbrojtës i ish-Presidentit Thaçi, në procesin gjyqësor që eshtë duke u zhvilluar përfshirë gati katër vite nga Dhomat e Specializuara në Hagë, si dhe për t'ju kerkuar mbështetje institucionale të karakterit financiar në mënyrë që i tekalohen këto sfida dhe në këtë proces gjyqësor të sigurohet së paku, minimumi i të drejtës kushtetuese dhe ligjore përsaqje efektive në drejtësi.

Siq e dini, Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 03 gusht 2015, krasas miratimit të Amendamenti nr. 24 të Kushtetutës, ka miratuar Ligjin Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe Ligjin Nr. 05/L-054 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proseset Gjyqësore në Dhomat e Specializuara, ku qëllimi i këtij të fundit ka përcaktuar qartë të drejtën për mbrojtje juridike dhe mbështetje financiare të të gjithë personave të akuzuar potencial në pajtim me juridikcionin dhe fushëveprimin e Dhomave të Specializuara. Madje, përmë tepër, nen 3 (Mbrojtja juridike) i këtij



## Jasharaj: Viti i ri shkollor mund të fillojë me vështirësi

**PRISHTINË, 22 GUSHT** - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se viti i ri shkollor mund të fillojë me probleme. Ai ka thënë se në shtator do të takohen për të vendosur përkërkësat e tyre të cilat, sipas tij, Ministria e Arsimit nuk u ka kthyer as përgjigje. "Ne kemi alarmuar me kohë dhe kemi thënë se duke bashkëbiseduar me punëtorët e arsimit, me

anëtarët e SBASHK-ut, ka pakënaqësi të mëdha. Kërkesat u bënë publike edhe më 1 maj, të cilat qeveria nuk i ka analizuar dhe nuk kemi ndonjë përgjigje pozitive prej saj. Sa i takon SBASHK-ut, viti i ri shkollor do të fillojë, besoj kam frikë me telash, për shkak të teksteve, pastaj ne gjatë shtatorit do ta kemi takimin e Këshillit Drejtues, që është organi më i lartë mes dy kongreseve dhe ata janë përfaqësues, të gjithë të punësuar në arsim, që nga çerdhet deri në universitet. Ata do t'i sjellin mendimet e bazës të anëtarësisë dhe cilitdo qoftë vendimi i Këshillit Drejtues, ne si staf, si kryesi e SBASHK-ut, do ta respektojmë" ka thënë Rrahmani për "Zërin". Ai e ka kritikuar MASHTI-në përmënyrën e shpërndarjes së librave, duke thënë se është duke e bërë gabimin e njëjtë.



## Nis ndërtimi i shkollës së re në lagjen "Mati 1"

**PRISHTINË, 22 GUSHT** - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, bashkë me drejtoreshën e Arsimit në këtë komunë, Jehona Lushaku-Sadriu kanë vënë gurthemelin e objektit të shkollës fillore të mesme të ulët në lagjen "Mati 1". Kjo shkollë parashihet që të ketë kapacitet për pranimin e mbi 700 nxënësve me një hapësirë prej 4 mijë e 800 metra katror, e cila pritet të funksionalizohet në korrik të vitit 2025.

Më këtë rast, Rama ka bërë me dije se kostoja e ndërtimit të tri shkollave, përfshirë atë në "Sofali" që do të fillojë javën e ardhshme dhe ajo në lagjen "Qëndresa" është mbi 15 milionë euro.

"4 mijë e 800 metra katror është e madhe shkolla. Investimi, ne veçse e kemi nënshkruar kontratën për një vit e gjysmë dhe është partneritet publiko-privat. I gjithë investimi është prej sektorit privat, ndërsa në momentin kur edhe shkolla përfundon dhe bëhet funksionalizohet, ne fillojmë të paguajmë mirëmbajtjen", ka thënë Rama. Ndërsa drejtoresha e Arsimit në Komunën e Prishtinës, Jehona Lushaku-Sadriu, ka thënë se kjo shkollë i përbushë të gjitha standardet evropiane për nga ndërtimi dhe dizajni përmësim tè rëndësishëm. "Kjo shkollë i përbush të gjitha standardet evropiane dhe për

nga nderti mi, dizajni përmësim tè rëndësishëm. Të jetë një shkollë përklasat e para deri në të pestat. Për shkak se do t'i shkarkojë shkollat e kryeqytetit 'Ismail Qemali' dhe 'Pavarësia', në ndërkojë që do ta kemi edhe një shkollë në Mat që do të mund ishte gjashtë deri nëntë dhe si lagje do të kompletohej me shkollë filllore dje të mesme të ulët", ka thënë Lushaku-Sadriu. Përveç kësaj, Lushaku e ka qujatur të paftë Ministrinë e Arsimit përmes mosfurnizimin e nxënësve me libra shkollor. Ajo ka thënë se në librari nuk ka libra të botuara përmësim tè rëndësishëm, sepse nuk kanë qenë të informuara me kohë.



## Policia sekuestron kokainë dhe heroinë në vlerë mbi 153 mijë euro



**PRISHTINË, 22 GUSHT (ER)** - Policia e Kosovës ka njoftuar se ka arrestuar dy persona të dyshuar si dhe ka sekuestruar substancë narkotike të llojit heroinë dhe kokainë. Në rastin e parë policia ka identifikuar një shtetas të Maqedonisë së Veriut, i cili dyshohej se kishte në posedim të gatshëm për shitje një sasi të substancës së dyshuar narkotike të llojit heroinë. "Të dyshuarit të lartëkëruar me veturë substancën e dyshuar narkotike ia kanë sjellë dy persona të tjera, të cilët janë larguar me veturë nga vendi i ngjarjes", ka njoftuar policia. Sipas këtij njoftimi, pas ndërryrjes së Policisë së Kosovës të personat i dyshuar janë gjetur 6 paketime me substancë të dyshuar

narkotike të llojit heroinë me peshë të përgjithshme prej 6.137.6 gramë (6 kilogramë e 137 gramë). Vlera e substancës së dyshuar narkotike e cila është konfiskuar vlerësohet të jetë rrëth 150 mijë euro. Lidhur me rastin, në cilësi të provave materiale, policia ka sekuestruar si prova materiale dy telefon celularë, një veturë dhe 4 305 denarë të Maqedonisë së Veriut. "Personi i dyshuar është shoqëruar përmes intervistimit në prezencë të avokatit mbrojtës dhe me vendim të prokurorit të shtetit i dyshuarit ndalohet për 48 orë, kurse dy personat e tjera janë në kërkim politor", ka njoftuar policia. Në rastin e dytë, Policia e Kosovës

## Naser Ramadani jep dorëheqje nga pozita e drejtorit të IKShPK-së

**PRISHTINË, 22 GUSHT** - Ministria e Shëndetësisë (MSH) ka konfirmuar dorëheqjen e drejtorit ekzekutiv të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), Naser Ramadani.

Nëpërmjet një përgjigje, Ministria e Shëndetësisë (MSH) ka njoftuar se dorëheqjen e Ramadanit e ka pranuar më 14 gusht të këtij

viti. Po ashtu, MSH-ja ka bërë me dije se ushtruese detyre e shefes së këtij institucioni shëndetësor është caktuar Arditë Baraku. "Ju njoftojmë se më 14.08.2024 ministri i Shëndetësisë ka pranuar dorëheqjen e dr. Naser Ramadani nga pozita e drejtorit ekzekutiv të IKShPK-së. Me vendim të ministrit të

Shëndetësisë, ushtrues detyre i drejtorit ekzekutiv të IKShPK-së është caktuar dr. Arditë Baraku, specialiste e Shëndetësisë Publike në Departamentin e Mjekësisë Sociale në IKShPK", ka njoftuar MSH-ja. Kujtojmë se Naser Ramadani e ka ushtruar detyrën e drejtorit të IKShPK-së përrreth 12 vjet.



## Maqedonci dhe Jashari nderojnë Gecin me medaljen për shërbim të shqar

**PRISHTINË, 22 GUSHT** - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënent Bashkim Jashari, me rastin e pensionimit të Sejdi Gecit, shef i sektorit për bashkëpunim civilo-ushtarak, në pritjen e

organizuar për këtë rast, për performancën e lartë, përkushtimin dhe kontributin e tij të dalluar në zhvillimin e kapaciteteve të Ministrisë së Mbrojtjes, ia kanë ndarë medaljen për "Shërbim të Shqar". Duke i dëshiruar pensionim të qetë, shëndet e të mira në

jetë, ministri Maqedonci ka shprehur mirënjojje për angazhimin e tij të pakursyer dhe të pandëprerë në rritjen e bashkëpunimit civilo-ushtarak, që ka qenë kontribut i drejtë përdrejtë në rritjen e besueshmërisë nga qytetarët për FSK-në dhe Ministrinë e Mbrojtjes.



## Fillon digjitalizimi i procesit zgjedhor në Kosovë, KQZ-ja pranon softuer nga OSBE-ja



**PRISHTINË, 22 GUSHT** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka pranuar nga misioni i OSBE-së në Kosovë softuerin i cili do t'i digitalizojë disa nga operacionet zgjedhore.

Ky softuer do t'uа mundësojë votuesve në çdo kohë, jo vetëm gjatë zgjedhjeve, ndërrimin e Qendrës së Votimit brenda komunës. Po ashtu, përmes këtij softueri votuesit me nevoja të veçanta do t'mund të regjistrohen nga shtëpia dhe në ditën e zgjedhjeve, KQZ-ja do ta dërgojë ekipin mobil për t'uа mundësuar pjesëmarrjen në zgjedhje. Ndërsa përvotuesit janë vendit, platforma elektronike do ta mundësojë aplikimin për regjistrimin e tyre. Me këtë rast, kryesuesi i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, ka thënë se pranimi i këtij softueri vë në pah përkushtimin për avancimin e procesit zgjedhor. Ai ka theksuar se Kosova ka një traditë që çmohet edhe nga misionet ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve dhe ka shprehur besimin se KQZ-ja do t'ë

arrijë t'i kryejë detyrat e veta sërisht. Sipas Radoniqit, Ligji i ri për Zgjedhjet e Përgjithshme ka bërë shumë ndryshime në procesin zgjedhor brenda dhe jashtë vendit dhe zbatimi i tij do t'jetë sfidues. "Me Ligjin e ri për Zgjedhjet e Përgjithshme procesi zgjedhor si brenda, por edhe jashtë vendit ka pësuar ndryshime thelbësore dhe sigurisht se zbatimi i tij do t'jetë sfidues në zgjedhjet e datës 9 shkurt 2025, por shpreh gatishmërinë e KQZ-së për t'i përmbrushur detyrat që dalin para nesh. Besoj se përvaja ndërvite e KQZ-së dhe suksesi në të kaluarën do t'jenë motive për të gjithë ne që me sukses ta realizojmë misionin tonë për organizim të zgjedhjeve me standarde të larta ndërkombëtare, duke siguruar shprehjen e vullnetit të lirë të qytetarëve me të drejtë vote të Republikës së Kosovës. Organizimi i zgjedhjeve eshtë një ndër proceset më të mëdha dhe gjithëpërfshirej për një shtet. Kosova tashmë ka një traditë që çmohet edhe nga misionet ndërkombëtare të

vëzhgimit të zgjedhjeve. Ky nuk eshtë vetëm një tregues përpunën e KQZ-së, por një imazh i shtetit tonë të ri në arenën ndërkombëtare. Kosova duhet të vazhdojë t'i tregojë botës shembullin e mirë në organizimin e zgjedhjeve", ka thënë Radoniqi, duke shtuar se KQZ-ja eshtë duke bërë hapa të rëndësishëm për digitalizimin e procesit. Jemi këtu që ta dorëzojmë softuerin për Qendrën e Numërimit të Votave dhe Rezultateve, softuer ky që eshtë zhvilluar me ndihmën e OSBE-së në Kosovë, ka përqelli qëllim t'i avancojë shërbimet e institucionit për votuesit, subjektit politike dhe vëzhguesit e zgjedhjeve. Shpreh mirënjojje për OSBE-në dhe ambasadorin Davenport për ndihmën që pa dyshim do ta avancojë procesin zgjedhor në Kosovë", ka thënë ai. Ndërsa shefi i misionit të OSBE-së në Kosovë, Michael Davenport, i cili ka bërë dorëzimin e softuerit, ka thënë se zgjedhjet e lira janë themel i demokracisë. Ai ka thënë se ky softuer do t'jetë një arsy me shumë që votuesit të besojnë në procesin demokratik.

Ai ka thënë se ky softuer eshtë një hap përparrë për efikasitetin, transparencën dhe integritetin e procesit zgjedhor. "Misioni i OSBE-së vazhdon ta mbështesë KQZ-në, siç ka bërë për shumë vjet, veçanërisht tani kur KQZ-ja po ecën përparrë me digitalizimin e procesit. Jemi këtu që ta dorëzojmë softuerin për Qendrën e Numërimit të Votave dhe Rezultateve, softuer ky që eshtë zhvilluar me ndihmën e OSBE-së në Kosovë. Dorëzimi i softuerit sot prezanton kulminacionin e bashkëpunimit tonë. Kemi punuar pa lodhje për këtë softuer vitin e kaluar, që ky softuer t'i përmbrushë kërkosat komplekse. Ky softuer eshtë një hap përparrë për efikasitetin, transparencën dhe integritetin e procesit zgjedhor. Koha eshtë esenciale sepse softueri vjen pikërisht para kohës së zgjedhjeve", ka thënë Davenport. Gjatë prezantimit të softuerit, zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka treguar se me anë të këtij softueri do t'ë bëhet e mundur që "në çdo

kohë, jo vetëm gjatë zgjedhjeve, por edhe në periudha jozgjedhore, do t'ë bëhet i mundur ndërrimi i qendrës së votimit brenda komunës dhe caktimi i saj sa më afër vendbanimit". Gjithashtu, Elezi ka treguar se përmes digitalizimit po lehtësitet edhe procesi i regjistrimit të votuesve janë Kosovë apo edhe regjistrimi i vëzhguesve. "KQZ-ja do t'ë vazhdojë t'ë prezantojë gjatë ditës së zgjedhjeve t'ë dhënat për pjesëmarrjen në votime, duke shfaqur edhe t'ë dhëna për pjesëmarrjes sipas grupmoshave dhe sipas gjinisë, ndërsa në mbrëmjen e së dielës së zgjedhjeve do t'ë fillojë publikimin e rezultateve preliminare për subjektit politike. Votat për kandidatët për deputetë do t'ë fillojnë t'ë numërohen nga e hënë pas ditës së votimit në qendrat komunale t'ë numërimit, t'ë cilat kryesisht do t'ë caktohen në palestra sportive dhe rezultati i kandidatëve për deputetë do t'ë publikohen në mënyrë progresive", ka thënë Elezi.

## Kapen të padeklaruar 71 kavanoza me mjaltë në Zubin Potok

**ZVEÇAN, 22 GUSHT** - 71 kavanoza me mjaltë janë gjetur dhe konfiskuar në Zubin Potok nga Policia e Kosovës. Me urdhër të prokurorit, vutura me targa të huaja të huaja dhe malli i padeklaruar

janë dërguar në terminalin doganor. "Gjatë patrullimit njësiti policor ka ndaluar veturën me targa të huaja të cilin e drejtonte i dyshuar mashkull kosovar, pasi i njëjti kishte kaluar ilegalisht kufirin.

Gjatë kontrollit eshtë vërejtur se në veturë kishte 71 kavanoza me mjaltë. Me urdhër të prokurorit vatura dhe malli janë dërguar në terminalin doganor", ka njoftuar policia.



## Abdixhiku: Më 9 shkurt marrin fund vonesat infrastrukturore, historia rrugore do të kompletohet brenda një mandati

**PRISHTINË, 22 GUSHT** - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka inspektuar punimet që janë duke u zhvilluar në ndërtimin e rrugës në lagjen Velania. Ai ka thënë se kjo rrugë do t'i eliminojë kolonat e gjata. "Në infrastrukturë, ndonjëherë, del një projekt që duket aq i thjeshtë, dhe është i thjeshtë, por në thelb bën ndryshime të mëdha. I tillë është projekt i Velani. Secili që ka marrë rrugën nga udhëkryqi i Taslixhes për në Velani e të dalë sipër në Breg të Diellit apo Mat është dashur të kalojë nëpër njëren nga katër rrugicat e lagjeve - mu pranë shtëpive. Kolona të gjata, pasiguri për banorë e vonesa

për secilin tjetër që s'kishte alternativë tjetër. Krenari kishte një ide. Të krijojë një rrugë të re - ngjitur me 'SOS Fshatin' - për t'u lidhur drejt me Mat, Breg të Diellit e përfundimisht Rrugën B, e kështu për ta shmangur nevojën e kalimit nëpër rrugicat e shtëpive. Sa e thjeshtë! Sot vizitova punimet që po zhvillohen aty. Dinamizëm i madh. Entuziazëm mes banorëve. Rrugë e re, dy kahe, me trotuare e ndriçim. Transformim rrënjosor jo vetëm për banorët e Velanisë, por për secilin qytetar që ka kaluar andej. Banorët më thanë se ende nuk po e besojnë se kjo po ndodhte. Për ta kjo ishte një ide sa e bukur aq dhe e pamundur.



U thash të rrinë të qetë", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook". Abdixhiku ka lavdëruar punën e drejtorit të Investimeve Kapitale

kisha këshilltar në ministri. Ishte i përpiktë, punëtor i pashoq, mbi të gjitha ishte njeri i mbarë e i drejtë. Kur je i drejtë, puna të shkon mbarë. Atëherë kishim përfunduar rrerhrotullimin e Veternikut për 31 ditë. Krenarit i ka shkuar gjithnjë puna mbarë. Nuk kisha asnjë dyshim që nga dita që mori detyrën e drejtorit të Infrastrukturës në kryeqytet", ka shkruar ai.

Më tutje, Abdixhiku ka thënë se më 9 shkurt të vitit 2015 do të marrin fund vonesat infrastrukturore. "Historia rrugore e Kosovës do të kompletuhet brenda një mandati të vetëm. Tjetër tempo, tjetër mendësi, tjetër angazhim", ka shkruar kryetari i LDK-së.

## Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e statistikave dhe financave

**PRISHTINË, 22 GUSHT** - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka nënshkruar të enjten një marrëveshje mirëkuptimi me Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) dhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Nënshkrimi i kësaj marrëveshje është bërë në ambientet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK-së) nga Avni Kastrati, ushtrues detyre i kryeshefit ekzekutiv të kësaj agjencie, Hekuran Murati, ministër i MFPT-së dhe Ahmet Ismajli, guvernator i BQK-së.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje ndërmjet tri institucioneve përpiluese të statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës, Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), si prodhuesi kryesor i zyrtar i statistikave në vend, Bankës Qendrore të



Republikës së Kosovës (BQK), si dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)/Thesari i Kosovës, është e rregulluar sipas ligjeve kombëtare, duke zbatuar standardet e parashikuara në aktet ligjore të BE-së si dhe programet zyrtare vjetore përsistemin kombëtar statistikor.

makroekonomike dhe financiare. Kjo marrëveshje është e rregulluar sipas ligjeve kombëtare, duke zbatuar standardet e parashikuara në aktet ligjore të BE-së si dhe programet zyrtare vjetore përsistemin kombëtar statistikor.

Me rastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, Kastrati ka theksuar rëndësinë e këtij bashkëpunimi ndërinstitucional për t'i përbushur udhëzimet statistikore ndërkombëtare përcilësinë e të dhënave, siç pëershruhen në marrëveshjen e tri institucioneve.

Ndërsa guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismajli, ka thënë se "kjo marrëveshje, formalisht e shënon një koordinim ndërinstitucional të të tri institucioneve prodhuase të statistikave përvancimin e sistemit statistikor të Kosovës nga sistemi i përgjithshëm i shpërndarjes së të dhënave (GDDS) në standardin e veçantë të shpërndarjes së të dhënave (SDDS), si një standard më i avancuar, i cili promovon përmirësimin e kualitetit, transparencës dhe disponueshmërisë së

informatave statistikore". Në anën tjetër, ministri Hekuran Murati ka thënë se "kjo marrëveshje është edhe një hap drejt standardizimit dhe kahasimit ndërmjet platformave, si dhe ndërlidhja e këtyre platformave, duke evitar edhe çështjen e privatësisë së të dhënave".

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje përbën një hap të rëndësishëm për përbushjen e zotimeve të vendit ndaj rekandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) përvancimin e mëtejshëm të përpilimit dhe raportimit statistikor, të diskutuara dhe të dakorduara në takimet pranverore të FMN-së në Uashington D.C.

ASK-ja mbetet e përkushtuar përrarrjen e standardeve më të larta të përpilimit dhe raportimit të dhënave statistikore.

## BQK-ja: Ekonomia e Kosovës pritet të rritet 3.9 përqind gjatë këtij viti

**PRISHTINË, 22 GUSHT** - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka njoftuar se parashikimet sugjerojnë se ekonomia e Kosovës pritet të rritet më shpejt gjatë vitit 2024, e mbështetur nga rritja e të ardhurave reale të disponueshme, falë uljes së inflacionit dhe rritjes së burimeve të financimit.

Sipas projekteve të BQK-së, ekonomia pritet të rritet 3.9 përqind gjatë vitit 2024. Kjo rritje pritet të mbështetur nga rritja e konsumit, investimeve dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve. "Ndërkohë, importi i mallrave dhe shërbimeve pritet të ketë një ndikim negativ në rritjen e BPV-së", është thënë në raportin e BQK-së përvlerësimin e

tremujorit të parë të ekonomisë. BQK-ja ka njoftuar se sipas vlerësimeve preliminare të ASK-së, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 5.6-përqindësh në TM1 2024.

"Përspektimi i rritjes ekonomike kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar lidhet kryesisht me dinamikën e kërkesës vendore, ndërsa eksportet neto ndikuan negativisht aktivitetin ekonomik si rezultat i rritjes së kërkesës vendore që u shqërua me rritje të importit, liberalizimit të vizave që ka ndikuar në rritjen e importit të shërbimeve të udhëtimit, dinamikave të çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe kërkesës së dobësuar në Eurozone", është



thënë në raport. Rritja ekonomike në TM1 2024, sipas BQK-së, është mbështetur kryesisht nga konsumi dhe

investimet, që kanë kontribuuar 9.1 përqind, përkatësisht 1 pikë në përqindje. "Në TM1 2024 konsumi është rritur për 8.9 përqind, një rritje shumë më e lartë kahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Investimet shënuan rritje për 3.1 përqind kryesisht për shkak të rritjes së investimeve publike dhe kreditimit. Sa i përket tregtisë së jashtme, eksportet neto thelluan deficitin tregtar për 12.7 përqind. Rritja e deficitit tregtar ishte pasojë e rritjes së importit të mallrave dhe shërbimeve për 9.1 përqind (importi i mallrave shënoi rritje për 6.9 përqind, ndërsa importi i shërbimeve shënoi rritje për 30.8 përqind), si dhe rënje të eksportit të mallrave për 1.9 përqind, ndërsa eksporti i shërbimeve shënoi rritje për 14 përqind", është thënë në raportin e BQK-së.

George F. KENAN: MEMOARE 1925-1950 (6)

# Bashkimi Sovjetik kishte plane për shkatërrimin e prestigjit dhe fuqisë së ShBA-së

Përfundime praktike nga pozita e politikës amerikane



**Shkuan:**  
Prof. dr. Agim ZOGAJ

Marrë në tërësi, para vetes kemi një forcë politike të bindur me fanatizëm se me ShBA-në nuk mund të ketë një modus vivendi afatgjatë, të përhershëm, se është e dëshirueshme, e preferueshme dhe domosdoshme të thyhet boshti, qëndrueshmëria e shoqërisë sonë, të shkatërrohen mënyra e jonë tradicionale e jetës, të shkatërrohen prestigji, autoriteti ndërkombëtar i vendit tonë, e gjithë kjo pra nëse dëshirohet të sigurohet sundimi, fuqia e Bashkimit Sovjetik.

Kjo forcë politike gjëzon të gjitha të drejtat që të shërbehet, t'i ketë në dispozicion energjitet e një ndër popujve më mëdhenj në botë dhe me resurset e territorit më të pasur nacional në botë, ndërkohë që frymëzohet me rrymat e fuqishme dhe të thella të nacionalizmit rus. Krahas kësaj, ajo e ka të zgjeruar me kujdes dhe gjerësisht mekanizmin përkryerjen e ndikimit të vet në vendet e tjera, mekanizëm, ky jashtëzakonisht elastik dhe i ushtruar, i udhëhequr me njerëz të cilët kanë përvojë dhe shkatërtësi më metodat ilegale si askush tjetër në botë. Së fundi, sipas të gjitha gjasave, ajo në reaksionet e veta themelore aspak nuk merr parasysh realitetin. Problemi se si do të ia dalim në fund me këtë fuqi, është gjithsesi detyra më e rëndë para të cilës ndonjëherë është gjetur diplomacia e jonë dhe sigurisht se është sfida më e madhe me të cilën do të duhet të ballafaqohet.

Kjo do të duhet të kiske pika nismëtarë për veprim, të gjeneralshtabit tonë politik në situatën e tanishme kritike. Kësaj duhet qasur me themel dhe me kujdes sikur në zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme strategjike në luftë, edhe pse është e nevojshme, që në planifikim të qasemi me koncentrim dhe angazhim, përpjekje të njëjtë. Këtu, me këtë rast unë nuk mund të përpinqem t'i propozoj të gjitha përgjigjet. Mirëpo dëshiroj të shprehi mendimet e mia, se jemi në gjendje ta zgjidhim këtë problem pa përdorur ndonjë konflikt të përgjithshëm ushtarak. Në lidhje me këtë, përkatësisht si kontribut këtij konfirmimi, vërtetimi, fakti do t'i paraqes disa

pikëpamje të mia të cilat janë të natyrës optimiste:

## Rusët tërhiqen vetëm kur hasin në rezistencë

(E para) Fuqia sovjetike, për dallim nga fuqi e Gjermanisë hitleriane, nuk është as skematike as aventuriere. Ajo nuk vepron sipas planit të përcaktuar. Ajo nuk përfshinë, pranon rreziqet e panevojshme. Edhe pse duket e heshtur sa i përket logjikës së arsyes, ajo është shumë endjeshme ndaj logjikës së fuqisë. Prandaj, nisur nga kjo ajo fare lehtë tërhiqet - çfarë edhe zakonisht e bënë - kur në cilën do pikë has në rezistencë të fort. Kështu, nëse kundërshtari i saj ka mjaft fuqi, forcë dhe e dëshmon qartë gatishmërinë e vet që ta përdor atë, atëherë rrallëherë do të jetë i detyruar për këtë. Nëse veprohet drejt në situatat e caktuara, atëherë nuk ka nevojë për ballafaqime me qëllim të prestigjit. (E dyta) Në krahasin me Perëndimin si tërësi, sovjetët edhe më tej janë anë e dobët. Prandaj suksesi i tyre vërtet do të varet nga kohezioni, forca, qëndrueshmëria të cilën bota e Perëndimit mund ta arrijë. Ky ndërkaq, është faktor të cilin ne mund të ndikojmë.

(E treta) Sistemi sovjetik, si formë e sundimit të brendshëm, edhe më tej nuk e ka dëshmuar suksesin e vet. Më vonë do të tregohet, shihet nëse ai mund të mbijetoj provimin më të fundit - bartjen e pushtetit nga një personalitet tek tjeteri, përkatësisht nga një grup tek grupi tjeter. Kur kiske vdekur Lenini kiske ndodhur aso bartje e pushtetit sa që pasojat e asaj bartje plot 15 vjet e kanë dridhur shtetin sovjetik. Rasti i tillë i dytë do të ndodhë kur të vdes Stalini, ose kur ai të tërhiqet nga pushteti. Mirëpo, madje as kjo nuk do të jetë provimi përfundimtar dhe vendimtar për sovjetët. Sistemi i brendshëm sovjetik, për shkak të ekspansioneve më të hershme territoriale, do të ekspozohet me një varg sfidash të cilat në kohën e vet ishin dëshmuar, treguar si pengesë e madhe përmbrëtërinë. Ne këtu, me këtë rast jemi të bindur se masa e popullit rus kurrënjëherë, që nga përfundimi i luftës qytetare, nuk është më e larguar emocionalist sessa sot nga doktrina e Partisë komuniste.

Tani në Rusi, partia është bërë mekanizëm i madh, dhe aktualisht, mekanizëm i sukseshëm i udhëheqjes, administratës diktatoriale, mirëpo ka përfunduar të jetë frymëzim burimor emotiv. Prandaj, nisur nga kjo mund të kuptohet se lëvizja nuk disponon me sigurinë dhe koherencën e brendshme.

(E katërtë) E gjithë propaganda

sovjetike jashtë kufijve të sferës sovjetike të siguri të është negative dhe destruktive. Për këtë shkak relativisht do të ishte dashur të ishte lehtë të luftohet kundër asaj me çfarëdo programi të arsyeshëm dhe vërtet konstruktiv.

## Nuk guxojmë t'i frikësohem i Rusisë!

Nga këto arsyen mendoj se qetë dhe me optimizëm mund t'i qasemi problemet se si duhet të veprojmë me Rusinë. Lidhur me atë se, çfarë do të duhet të ishte ajo qasje, i kam edhe disa sugjerime, vërejtje të cilat dëshiroj t'i paraqes, parashtroj në përbillyje:

1. Para së gjithash, duhet të kuptojmë dhe të pranojmë natyrën e vërtet të lëvizjes e të cilën kemi punë. Duhet ta studiojmë me aq seriozitet, objektivisht dhe pa shqetësimë, anime, subjektivizëm, dhe me një vendosmëri të tillë të mos i lejojmë që emotivisht të mos na nxis ose të na hedh nga stabiliteti.
2. Duhet të kujdesemi, të bëjmë përpjekje që opinioni ynë ta njeh gjendjen e vërtetë, reale në Rusi. Nuk kam fjalë për të thënë në mënyrë të mjaftueshme se sa është kjo me rëndësi. Këtë nuk mund ta bëjë vet shpty, por kryesishet dhe në radhë të parë organet shtetërore të cilat janë domosdoshmërisht më me përvojë dhe më mirë e informuar lidhur me problemet përkatëse praktike. Për këtë nuk guxojmë të strukemi para pamjes së shëmtuar. Besoj se sot në vendin tonë do të kiske më pak antisovjetizëm histerik sikur bota e janë do ta kuptonte më mirë realitetin e asaj gjendje. Nuk ka asjë aq të rrezikshme ose aq të tmerrshme sikur që është e panjohura. Këtë mund të paraqitet kundërgjegjësimi, më mënyrë që zbulimi më i madh i vështirësive tona me Rusinë të shoqërohej në marrëdhëni amerikan - ruse. Mirëpo, konsideroj se nëse në këtë ka ndonjë rrezikshëm, atëherë ne duhet të kemi guxim, kurajë që të ballafaqohemi me të, dhe atë sa më parë aq më mirë. Mirëpo, megjithatë nuk shoh se mund të ketë rrezik për ne. Kontributi, roli ynë në këtë vend, madje edhe sikur të kiske ardhur pas manifestimeve të mëdha të miqësisë sonë ndaj populli rus, është shumë i vogël. Ne këtu nuk kemi investime të cilat do të ishte dashur t'i ruanim, nuk kemi këmbim të atillë tregtar, i cili do të dobësohej, praktikisht nuk kemi qytetarë të cilët do t'i mbronim, kurse ka pak lidhje kulturale të cilat ishte dashur t'i ruanim. Rreziku ynë i vërtetë qëndronim në atë në çka shpresojmë dhe jo në atë që tani më e kemi, dhe unë besoj se do t'i kemi gjasat më të mira për

realizimin e asaj shprese nëse opinioni ynë do të informohet dhe nëse marrëdhëni tona me Rusinë vendosen plotësisht në bazat realiste dhe konkrete.

## Për rusët, të gjithë të huajt janë armiq potencial!

*Komunizmi botëror i përgjegjësuar parazitit*

3. Shumë varet nga ajo se në çmasë shoqëria e jonë është e shendosh dhe e fortë. Komunizmi botëror i përgjegjësuar parazitit i cili ushqehet vërtet me inde të sëmura. Kjo është pikë në të cilën pikëtakohen politika e jashtme dhe e brendshme. Çfarëdo mase e rendësishme dhe e theksuar e drejtuar në zgjdhjen e problemeve të brendshme të shoqërisë sonë, në ngritjen vëtëbesimit, disiplinës, moralit dhe unitetit të popullit tonë, është fitore diplomatike ndaj Moskës, fitore e cila vlen sa mijëra nota diplomatike dhe komunikata të përbashkëta. Nëse ne nuk jemi në gjendje t'i i hedhim fatalizmin dhe indiferencën para mangësive, dobësive në shoqërinë tonë, Moskë do të trimërohet – Moskë në mënyrë të paevitueshme do të shërbehet me te në politikën e saj të jashtme.
4. Ne duhet ta formulojmë një pamje, fotografi të fatit të botës, dhe ta paraqesim para botës, pamje kjo e cila do të jetë shumë më pozitive dhe më konstruktive nga ajo të cilën e kemi paraqitur më herët, më parë. Nuk është e mjaftueshme të nxiten popujt që t'i zhvillojnë proceset politike të ngashhme proceseve tona. Shumë popuj, së paku në Evropë, janë të lodhur dhe të tmerruar me përvojat e të kaluarës prandaj më tepër ju intereson siguria sesa liria abstrakte. Ata më tepër lakmojnë për udhëheqje, sesa përgjegjësi. Kurse ne duhet të jemi më të aftë se rusët që këtë t'u japid, ofrojmë. Nëse ne këtë nuk ua japid, rusët atëherë këtë e duan plotësisht.

5. Së fundi, ne duhet me guxim dhe me vëtëbesim të përbahemi metodave dhe koncepcioneve tona për shoqërinë njerëzore. Nga ana tjetër, rreziku më i madh i cili mund të na kanoset në ballafaqimin me problemin e komunizmit sovjetik qëndron në atë që mund të na ndodhë të bëhem i njëjtë sikur ata me të cilët po ballafaqohemi.

## D. Fragmente nga ShBA-të dhe Rusia (dimër 1946)

Historikisht, veprimitarë e politikës së jashtme të ShBA-së dhe të Rusisë janë zhvilluar sipas linjave krejtësisht të ndryshme. Marrëdhëni tona më të rendësishme me jashtë, thënë historikisht, kanë rrjedhur përmes

linjës së tregtisë paqësore përtëj oqeanit. Kjo linjë ka theksuar bazat, themelet e konceptit, opinionit tonë për punët e jashtme. Mirëpo, rusët, gjatë tërë historisë së tyre kanë pasur punë kryesisht me fqinjtë e egër, të disponuar armiqësish. Në mungesë të barrierave, pengesave gjografike, me qëllim që t'ia dilnin me ata fqinjë, ata ishin detyruar të zhvillonin metodën e llojit të vet (e cila sot është bërë tradicionale dhe automatike) të përparimit dhe të tërheqjes elastike, të mbrojtjes sipas thëllësisë, konspiracionit, kujdesit dhe dinakërisë. Historia e tyre di për shumë marrëveshje paqe, armëpushime ndërmjet forcave armiqësore, mirëpo kurrënjëherë nuk e ka ditur, njohur shembullin e paqes, koekzistencës së përhershme midis dy shteteve fqinje në kufijtë e vendosur të cilën pa vërejtje e kanë përkrahur, pranuar të dy popujt. Prandaj rusët nuk kanë kurrëfarë paragjykimi për marrëdhëni përhershme midis shteteve. Për ata, të gjithë janë të huajt, janë armiq potencial. Metoda e diplomacisë ruse, sikur edhe e diplomacisë së Lindjes në përgjithësi, është e atillë që kundërshtarin e caktuar ta impresionoj duke e frikësuar me forcën ruse, që rruget dhe mënyrat e zbatimit të asaj fuqie t'i mbështjell me vallon e fshehtësisë, me çka armikun, kundërshtarin e huton, e mban në paqartësi, dhe në këtë mënyrë atë e detyron që ndaj aspiratave dhe pikëpamjeve ruse të sillet me respekt të veçantë dhe me konsideratë. Kjo nuk ka asgjë të përbashkët me kultivimin e marrëdhënieve miqësore, ashtu si ne i paramendojmë.

## Amerikanët mund të shtyen fare lehtë me rusët

Neve do të na ishte shumë më lehtë që të shtyhem me Rusinë, nëse sinqerisht vet vetit do t'i kishim pranuar faktin se udhëheqësit e saj, sipas aspiratave të tyre, janë armiq të gjithë saj pjesë të botës me të cilin ata nuk sundojnë dhe që sipas, në varësi të atij parimi të pranuar të orientohen, radhitën edhe mendimet dhe aksionet e gjithë organizimit sovjetik. Të kujtojmë edhe faktin se në Bashkinë Sovjetik, vendimet rrallëherë i bien individët. Ato i sjellin, marrin trupat kolektive. Prej atyre trupave kolektive kërkohet që të veprojnë në pajtim me teorinë se bota e jashtme është e predispozuar armiqësish ndaj Rusisë, dhe nuk është e gatshme për ndonjë akt

dinjitoz dhe jojetjak ndaj shtetit rus ose popullit rus. Nga kjo del se, asnjë akt i ndonjë qeverie të jashtme nuk mund të pranohet zyrtarisht si akt i vullnetit të mirë. Secili funksionar sovjetik i cili do të vente në pyetje, do ta kontestonte këtë parim dhe që do të përpinqej që në ndonjë organ sovjetik të dëshmoj se si ndonjë vend, shtet i caktuar ka bërë ndonjë gjest miqësor ndaj Bashkimit Sovjetik, dhe se përkëtë meriton mirënjoje, do ta kishte rrezikuar postin e tij. Në administratën sovjetike secili, gjithkush duhet të parashoh se qeveritë e jashtme veprojnë vetëm në interesine tyre personal dhe se falënderimi dhe

mirënjoja janë veçori, veti të panjohura në politikën e jashtme. Në këtë mënyrë, aparati i cili i udhëheq punët e jashtme sovjetike është i gatshëm t'i sheh vetëm arsyet e interesave konkrete ruse dhe të reagojë ndaj tyre. Askush në trupat e administratës sovjetike nuk mund të mbrojë kurfarë propozimi nëse nuk është në gjendje që konkretisht të dëshmojë se çfarë do të fitojnë interesat e Bashkimit Sovjetik nëse aprovohet ai propozim ose çfarë do të përfjetoj, duroj nëse a propozim hedhet, refuzohet. Ky parim aplikohet me bindjen se ai është objektiv. Me rastin e shqyrimit të ndonjë qëndrimit të

cilin e ka aprovuar ndonjë shtet i jashtëm, rusët nuk përpinqen që atë qëndrim ta shohin nga pozicioni i palës përkatëse të shtetit. Ata konsiderojnë se ai qëndrim është i diktuar sipas qëllimeve të cilat nuk janë të tyre (pra ruse) dhe i shqyrtojnë, analizojnë vetëm nga pikëpamja e veprimit të tyre mbi ata. Nëse ai vlerësim është i dobishëm, i favorshëm, ata e pranojnë pa falënderim; nëse ai është i pafavorshëm përsëri, ata atëherë e hedhin poshtë pa shprehjen e keqardhjes. Nëse, ne përkëtë do të kishim koshient, atëherë sigurisht se edhe vetit por edhe atyre do t'u kishim lehtësuar çështjen.

### Si duhet vepruar në marrëdhëni me rusët?

Në dritën e kësaj që kam thënë deri më tash, do të propozoj që në marrëdhëni me rusët t'u përbahemi këtyre parimeve:  
A. Të mos jemi intim ndaj tyre. Kjo individualisht vetëm se i huton dhe ju thellon dyshimet e tyre. Funksionarëve rus ju gërditet edhe vet ideja, mendimi që para popullit të vet të paraqiten si njerëz të cilët kanë zënë miqësi me ndonjë të huaj. Marrëdhëni e mira, ata nuk i paramendojnë në këtë mënyrë.  
B. Të mos paramendojmë, planifikojmë kurfarë qëllime të përbashkëta me të të cilat në

realitet nuk ekzistojnë.

Është përpjekje e kotë që rusët t'i shqyjmë drejt unitet, pajtimit duke u thirrur në qëllime të përbashkëta të cilat qëllime edhe ne e edhe ata i kemi theksuar me fjalë, siç është fjalë vjen forcimi i paqes botërore, ose i demokracisë, ose çfarëdo tjetër që duam. Atëherë kur i kanë theksuar ato qëllime, ata kanë pasur qëllimet e veta. Dhe ata mendojnë se edhe ne i kemi pasur qëllimet e ngashme. Për ata, e gjithë kjo është një lojë. Dhe kur ne të përpinqemi që t'u ofrohem i çfarëdo argumenti të mbështetur, bazuar në deklaratat e tillë të përbashkëta, ata atëherë bëhen dyfish më të kujdeshëm.

(Vijon)

## Ndarja e Amerikës, mes të shkuarës dhe të ardhmes



Sfida mes së shkuarës dhe së ardhmes është dimensioni përgjatë të cilët përballen Kamala Harris dhe Donald Trump, kandidatë demokratë dhe republikanë për presidencën amerikane. Pas largimit të presidentit aktual Joe Biden, i cili pas shumë hezitimësh vendosi të mos kandidojë më, duke lënë të lirë të kandidojë zëvendësen e tij, rolet u ndryshuan.

Nëse më parë Biden ishte i moshuari, shprehja e një bote të vjetruar, sot ky roli bie Trumpit, i cili është bërë befas kandidati më i moshuar. Një kontrast, ai është një shtatëdhjetë e tetë vjeçar, ajo është një pesëdhjetë e nëntë vjeçare e shkëlqyer, e cila do të jetë edhe më e pamëshirshme kur të dy do të përballen me njëri-tjetrin në debatin televiziv të 10 shtatorit në rrjetin ABC.

Trump, i vetëdijshëm se sa rëndësi ka pamja, u përhoq në çdo mënyrë për ta shmangur atë: ai e di shumë mirë se imazhi i tij pranë një gruaje më të re, më të bukur dhe më energjike, vetëm dëm mund të bëjë. Edhe më keq, mund ta bëjë atë të duket si ajo çfarë shumëkush e akuzon se është: një plak i zemëruar, arma e të cilët është denigrimi i kundërshtarit dhe i cili, kur përballet me një grua kompetente, kënaqet duke përdorur mizogjininë.

Kandidati për zëvendëspresident i Harris, Tim Walz, guvernator i Minesotës, tha kohët e fundit: "Falënderoj Kamalan sepse ajo solli gjëzimin në këtë fushatë". Ai goditi një pikë themelore: me tërheqjen e Bidenit, ajo që ishte një fushatë e përgjumur, e mërzitshme, pa interes, veçanërisht në sytë e më të rinjve, është bërë një fushatë po aq

emocionuese sa një finale olimpike e 100-metërshtit.

Gjëja e parë që bëri Kamala Harris ishte ndryshimi i mesazhit: largimi nga fjalimet që e përshkruajnë Trumpin si një rrezik për demokracinë amerikane, dhe përparrë me një mesazh që shikon drejt së ardhmes në një mënyrë pozitive. Një nga sloganet e para, i lindur spontanisht gjatë një mitingu, është në fakt "Ne nuk do të kthehem prapa", duke iu referuar katër viteve të presidencës së Trump.

Harris vazhdon ta përsërisë sa herë që i duhet të kundërshtojë idetë e republikanëve mbi temën e abortit dhe riprodhimit të asistuar. Dimensioni tjetër në të cilin luhet dueli mes Harris dhe Trump është ai i lirisë, fjalë të cilën zv/presidentja e riktheu sapo mori rolin e kandidates. Liri për të dashur kë të doni (kundër

atyre që duan të kufizojnë të drejtat e personave LGBTQ+), për të menaxhuar trupin tuaj (kundër atyre që duan të kriminalizojnë abortin), për të bërë zgjedhje për shëndetin tuaj (kundër atyre që duan të heqin riprodhimin e asistuar), por edhe lirinë e nxënësve për të shkuar në shkollë pa frikën e vrasjeve (kundër atyre që duan armë falas).

Prandaj, liria bie ndesh me një nga temat më të përdorura nga republikanët në vitet e fundit: frikën. Frika nga ata që janë të ndryshëm (lexo emigrantët), por edhe nga ata që bëjnë zgjedhje të ndryshme, nga ata që zgjedhin të duan dikë që nuk do ta duam kurrë ose të kenë fëmijë në një mënyrë që nuk do ta përdorim kurrë.

Harris dhe Walz e kanë të lehtë t'i quajnë Trump dhe JD Vance,

senatorin e Ohajos të emëruar si zëvendës të tij, "ata të çuditshmit". Është një lëvizje komunikimi që po rezulton e suksesshme dhe që duket se e bezdis ish-presidentin sepse e kthen atë në të shkuarën. Por në këtë vend, Trump ka potencialisht një shans: të fitojë mbi amerikanët, të cilët, duke parë vitet e Harris si zëvendëse e Joe Biden, mendojnë: "Por a nuk ishin gjërat më mirë më parë?"

Ata janë qytetarë të një Amerike, ndoshta larg qyteteve të mëdha, ndoshta të përjashtuar nga mirëqenia ekonomike, që ndoshta nuk e shohin në modelet e reja të familjes dhe shoqërisë. Amerikanët që kujtojnë, në fakt, një të kaluar në të cilën gjithçka ishte më mirë. Përtë, "Le të mos kthehem pas" e Kamala Harris, tingëllon si një kërcënim. / bota.al

# Super armët e fushëbetejave moderne



Konflikti në Ukrainë është bërë përshtypjesi më i fortë për inovacionin e luftës çerekshkullin e fundit. Dhe kjo vlen si për industrinë ruse të luftës, ashtu edhe për atë euroatlantike. Po kështu për ato izraelite, kineze, iraniiane dhe koreano-veriore.

Lajmet nga kontekste të ndryshme luftarakë – nga Deti i Kuq në Detin e Kinës, nga Deti i Zi në Mesdhe – nxjerrin në pah një varësi në rritje të forcave të armatosura bashkëkohore nga makinat e pajisura me Inteligencë Artificiale (AI), të cilat tashmë kanë “infektuar” botën ushtarake me AI gjeneruese. Për shembull, parashikimi dhe paralajmërimi proaktiv i rreziqeve dhe sistemeve mbrojtëse; analiza e inteligjencës, shënjestrimi dhe logistikë përmisionet...

Sigurisht, edhe sot përdorimi i dronëve kamikaze mbetet demonstrimi më evident i rëndësishëm së armëve teknologjike në luftë përmarrë një avantazh strategjik: në fakt, përdorimi i sistemeve robotike të pajisura me inteligjencë artificiale ofron avantazhe të shumta duke përfshirë uljen e rreziqeve përmisionin, një rritje në efikasitetin operacional dhe aftësinë përmarrës së kryer misione në territorin e armikut, me saktësi më të madhe. Në këtë kuptim, një nga simbolet e konfliktit evropian quhet Lyagushka (që do të thotë “bretkocë”), një dron tokësor rus

që përfaqëson një ndryshim të rëndësishëm në strategjitet e miratuar nga forcat e armatosura të Moskës. Aftësia e tij përmarrës përfshirë tanket, e armikut pa u zbuluar dhe mundësia e mbajtjes së ngarkesave të konsiderueshme shpërthyese, po i mundëson Kremlinit të dëmtojë llogoret e armikut me efektivitet absolut. Suksesi i Lyagushkas varet pikërisht nga integrimi i AI dhe robotikës së avancuar, të cilat së bashku lejojnë që objektivi të llogaritet ose rillgaritet në varësi të kontekstit dhe llojit të mbrojtjes me të cilën përballet. I vënë në punë nga një motor elektrik dhe me aftësi goditjeje të shpejtë, Lyagushka është praktikisht i heshtur, madhësia e vogël dhe diapazoni i veprimit e lejojnë të kontrollohet nga mbi tre kilometra larg.

I aftë përmarrës së mbajtur deri në 30 kilogramë eksploziv, mund të përdoret nga një ekip prej tre ushtarësh: gjithçka që nevojitet është një telekomandë dhe syze speciale, të cilat ofrojnë shikim në kohë reale nga një kamerë e montuar në antenën e dronit. Shtetet e Bashkuara nuk janë prapa rusëve: shpikës si të dronëve, ashtu edhe të inteligjencës artificiale, sot ata janë gati të hedhin në treg avionin e ri pa pilot Switchblade 600, edhe ai i pajisur me AI. Është një armë ajrore 15 kilogramëshe, e pajisur me optikë me precizion të lartë dhe një raketë kundër tanke përmarrëse.

të eliminuar objektivat më rezistente, përfshirë tanket, e vënë në veprim nga toka me një katapultë të thjeshtë. Me një autonomi prej 40 minutash dhe një distancë prej 40 kilometresh, është në të gjitha aspektet një nga dronët kamikaze më premtues që ka Departamenti i Mbrotjes i Shteteve të Bashkuara.

Megjithatë, siç e pranoi Zëvendës Sekretarja e Mbrotjes e SHBA-së, Kathleen Hicks, ndërsa merrte pjesë në një konferencë mbi teknologjitetë të zhvillimt në Uashington, Pekini aktualisht ka një avantazh sasior përsa i përket armatimeve dhe personelit të trajnuar në teknologjitet e reja. Zyrtarja e lartë amerikane deklaroit se, përmarrës së ruajtur një diferençë avantazhi ndaj rivalit të vet kryesor, Pentagoni duhet të “shfrytëzojë më mirë” potencialin e AI.

Kërcënimi kryesor që vjen sot nga Kina është padyshim Dongfeng (“Era e Lindjes”), një raketë balistike që mund të lëshohet edhe nga automjetet e lëvizshme dhe është shumë e shpejtë përmarrës së mbajtur deri në 30 kilogramë eksploziv, mund të përdoret nga një ekip prej tre ushtarësh: gjithçka që nevojitet është një telekomandë dhe syze speciale, të cilat ofrojnë shikim në kohë reale nga një kamerë e montuar në antenën e dronit. Shtetet e Bashkuara nuk janë prapa rusëve: shpikës si të dronëve, ashtu edhe të inteligjencës artificiale, sot ata janë gati të hedhin në treg avionin e ri pa pilot Switchblade 600, edhe ai i pajisur me AI. Është një armë ajrore 15 kilogramëshe, e pajisur me optikë me precizion të lartë dhe një raketë kundër tanke përmarrëse.

Mund të lëshohet nga çdo platformë ajrore duke qenë në gjendje të ndryshojë llojin e kokës shpërthyese.

Sa i përket sistemeve “inteligjente” përmarrës së mbështetur trupat në terren, një i testuar tashmë me sukses (nga forcat e armatosura izraelite) është Alchemist: algoritmi kompjuterik i kësaj makinerie integron të dhënat në një platformë të unifikuar, identifikon objektivat dhe transmeton e njofton menjëherë ushtarët përmarrës së rreziqesh në distancë, që varojnë nga qindra metra në disa kilometra.

Për shkak se lëviz me shpejtësinë e drithës, ka municion të pakufizuar, nuk ka pothuajse asnjë kosto interceptimi dhe shkakton dëme minimale kolaterale.

Por sistemi i mbrotjes që konsiderohet të jetë me performancën më të lartë dhe që do të shohim të përdoret në vitet e ardhshme supozohet të jetë DragonFire, një armë lazer me energji të lartë e prodhuar nga partnerët e konsorciumit britanik DragonFire-Mbda-QinetiQ, së bashku me italianen Leonardon, por ende në fazë testimi.

Inovacioni shtyn drejt kontrollit të kostove dhe kjo është arsyesa pse Izraeli sapo ka krijuar një gjeneratë të re raketa më pak të kushtueshme se Storm Shadow ose Tomahawk, por ende me impakt të lartë: Demoni i Erës.

Mund të lëshohet nga çdo platformë ajrore duke qenë në gjendje të ndryshojë llojin e kokës shpërthyese.

Sa i përket sistemeve “inteligjente” përmarrës së mbështetur trupat në terren, një i testuar tashmë me sukses (nga forcat e armatosura izraelite) është Alchemist: algoritmi kompjuterik i kësaj makinerie integron të dhënat në një platformë të unifikuar, identifikon objektivat dhe transmeton e njofton menjëherë ushtarët përmarrës së rreziqesh në distancë, që varojnë nga qindra metra në disa kilometra.

Një listë e gjatë e armëve të së ardhmes, por tashmë funksionale. Ashtu si Bayraktar BT2 turk, droni bombardues më i shitur në botë, i kontrolluar nga një person i vetëm. Ose nëndetësja e re bërrhamore kineze, muret e jashtme të së cilës të mbuluara me mikrofibra optike lëshojnë impulse lazer që e shqyrron trupin e saj shumë shpejt, duke e bërë atë jashtëzakonisht të heshtur. Me pak fjalë, inteligjenca artificiale, robotika, llogaritja kuantike, armët hipersonike, energjia e drejtuar dhe teknologjia e fshehtë.

Por lufta kibernetike, sistemet e armëve hapësinore, mjetet tokësore pa pilot (UGV) dhe bioteknologjia janë gjithashtu kufijtë e rinj të industrisë së luftës. / bota.al



# **FFK-ja ndaloi video-materialet falas, Ademi: Kështu është në gjithë botën**



**PRISHTINË, 22 GUSHT** - Kryetari i Federatës së Futbolit të Kosovës, Agim Ademi, e ka arsyetur vendimin e fundit të kësaj federate për ndalimin e dhënies pagesë të momenteve kryesore të ndeshjeve të Superligës së Kosovës në futboll. Sipas tij, kjo praktikë aplikohet në të gjithë botën, derisa ka shtuar se FFK-së xhirimi i vetëm një ndeshje i kushton deri në 1 800 euro. Ademi për "KosovaPress" ka thënë se shuma e kërkuar nga FFK që këto materiale t'u dërgohen medieve është 115 euro për një ndeshje. "Injorantë që nuk e njohin çështjen ose injorantë që duan të flasin keq për federatën mund të flasin gjithçka. Kjo është në téré botën e njohur. Ne deri më tanë i kemi lënë para, jo që nuk kemi dashur t'ua marrim ose nuk kemi dashur ta bëjmë këtë punë,

k to mjete shkojn  t  gjitha n  klub. N  k t  vit e kemi nj  ndryshim tek operator i blerjes s  t  drejtave t  televizioni dhe sigurisht q  ndeshjet ne i organizojm  vet , i xhirojm  vet  dhe i paguajm  vet ... Neve na kushton 1 500 deri 1 800 nj  ndeshje p r ta xhiruar dhe n se shohim se sa kemi k rkuar p r t  mbuluar k to, kemi k rkuar nj  shum  q  c do televizioni, n se e p rpjes茅tojm  me ndeshje, i bie 115 euro p r nj  ndeshje, dhe t  thuhet nuk i kemi ato mjete esht  marre", ka th n  Ademi.

Tutje, i pari i FFK-s  theksoi se medie mund t  bashk punojn  me federat  edhe duke ofruar pajisjet e tyre p r xhirimin e ndeshjeve dhe n  k mbim do t  i marrin pamjet e ndeshjeve. "Ky esht  produkt i FFK-s  dhe nuk kemi k rkua

strikt që të na i japin ato para, por pse nuk mund të na i lirojnë për aq para të televizionit, ose me këto kombit e regjisë të jenë bashkëpunues me ne dhe me ata kombi do ta na xhironin aq lojë sa i bie një kompanie televizive pa para dhe ne ua japim pa para sepse nuk janë para që federata i merr për vete, asnjë cent, po e përsëris, asnjë cent, nga të drejtat televizive dhe nga këto momente më të rëndësishme të ndeshjeve që i kemi bërë dhe marrin kaq bujë, i marrin të gjitha klubet sepse është produkt i klubeve' theksoi ai.

I pari i FFK-së ka bërë me dije se tashmë me disa media është arritur marrëveshja për dhënien e këtyre video materialeve edhe me kushtet e reja të vendosura nga federata.

# Kosova U18 mposhtet nga Egjipti

**PRISHTINË, 22 GUSHT** - Hendballistet e Kosovës U18 janë mposhtur nga Egjipti në kuadër të garës për plasman (21-24) në Kampionatin Botëror në Chuzhou të Kinës. Të enjten herët në mëngjes, Kosova U18 pësoi me rezultat 29:22. Dallimi u bë në pjesën e parë të cilën Egjipti e fitoi 14:8. Më efikasja te Kosova ishte Arjeta Imeraj me shtatë gola. Gjashtë i shënoi Diana Dreshaj, ndërkaq me tri gola takimin e përfundoi Orgesa Gola. Pas dy fazave grupore, vashat e Kosovës po garojnë për plasman nga pozitat prej 21 deri në pozitën e 24-t. Të premten në mëngjes Kosova U18 luan ndaj Nigerisë përvendin e 23-të. Ndërkokë përvendin e 21-të luajnë Taipei Kinez dhe Egjipti. Ndeshja e sotme me Nigerinë është e fundit për Kosovën në Botërorin në Kinë. Të kujtojmë që për herë të parë një Kombëtare e Kosovës në konkurrencë të sportisteve në sportet ekipore është kualifikuar dhe po paraqitet në Kampionat Botëror.



SHKURT

## **FIBA: Kosova nga faza e parakualifikimeve evropiane për Botërorin e eSports në Basketboll NBA 2K**

FIBA ka komunikuar detajet e fundit të Kampionatit Botëror eFIBA Sezoni i 3-të, ku Kosova do të marrë pjesë për herë të parë. Këtë vit 61 ekipe nga 6 rajone do të jenë pjesëmarrëse dhe do të garojnë për një grupçmimesh prej 50 000 dollarësh. Kosova do t'i fillojë garat online nga faza e parakualifikimeve për rajonin e Evropës. Kjo fazë do të zhvillohet në datat 1-14 tetor 2024. Në rast kualifikimi, ekipi ynë do të marrë pjesë në kualifikueset rajonale, ku do të luftojë për të qenë një nga 8 ekipet finaliste në eFIBA World Finals që do të luhen fizikisht (Lan) në dhjetor 2024. FBK do t'ju njoftoj me kohë për të gjitha përgatitjet dhe ecurinë e kësaj iniciative me qëllim të përfaqësimit sa më dinjitoz të ekipit tonë. Federata e Esports e Kosovës është partnerë e FBK-së në këtë projekt.

## **Estonia fiton p rballjen ndaj Kosov s**

Kosova U16 ka pësuar nga Estonia me rezultat 76:41 (16:10, 14:8, 32:8, 14:15). Kjo sfidë ishte e vlefshme për vendet 17-20 në FIBA U16 Women's Euro Basket, Divizioni B, që po zhvillohet në Konya të Turqisë. Vashat e Kosovës ishin të barabarta me ato estoneze në fillim të ndeshjes dhe në dhjetë minutat e fundit, por periudha e dytë dhe tretë ishte vendimtare, ku Estonia në fund fitoi 76:41. Klea Gashi shënoi 22 pikë për Kosovën, kurse Gerta Hoti kishte shtatë pikë e dhjetë kërcime. "Dardanet" e reja të premtën do të ndeshen me Zvicrën dhe të shtunën me Luksemburgun në ndeshjet e fundit në këtë garë.

## **Alonso: Bayerni është favorit për titull**

Gjatë konferencës për shtyp në prag të ndeshjes së parë në Bundesliga në mes të Bayer Leverkusenit dhe Borussia Monchengladbachut, trajneri Xabi Alonso ka bërë parashikimin e tij në lidhje me renditjen përfundimtare të kampionatit, duke ia "lënë" titullin Bayernit. Është e qartë se qëllimi i deklaratës ishte ta lironë skuadrën e tij nga ndonjë presion për shkak të fitores së papritur të sezoni të kaluar. "Për mua, Bayerni është favorit, kjo është e qartë. Flasin skuadra dhe historia. Objektivi ynë është të qëndrojmë mes katër të parëve. Është objektiv i realizueshëm. Kemi një skuadër të mirë", ka thënë Alonso.

## Wenbanyama: Jam i shqetësuar për kundërshtarët që do të përballen me mua pas disa vitesh

Paris, 22 gusht - Basketbollisti shtatlartë francez Victor Wenbanyama nuk e ka harruar ende humbjen në finalen e Lojëve Olimpike "Paris 2024", ku kombëtarja e tij u mund 98-87 nga Amerika. Për 20-vjeçarin,

kjo ishte pjesëmarrja e parë olimpike pas debutimit sezonin e kaluar në NBA me San Antonio Spurs. I gjatë 2.24 metra, ai ka qenë një makth për të gjithë në parket, i jashtëzakonshëm nën tabelë.

"Kujtoj që isha mjaft i trishtuar pasi përfundoi ndeshja, por nga ana tjetër kuptoj se kemi bërë rrugëtimin tonë dhe jemi paraqitur mirë. Falënderoj edhe një herë tifozët që na mbështetën", ka thënë

Wenbayama. "Në karrierën time përpinqem t'i bëj gjérat pa pasur asnjë keqardhje, ndaj deri më tani nuk kam asnjë të tillë: Si nga sezonin i kaluar në NBA me Spurs ashtu dhe nga Olimpiada. Po mësoj ende, jam i ri."



## Schumacher: Formula 1 është prioriteti im, për sa kohë kam një shans do ta pres rikthimin

GENOLIER, 22 GUSHT - Ka vetëm pak vende ende të disponueshme për sezonin 2025 të Formulës 1 dhe shumë pilotë shpresojnë ta marrin "biletën" e tyre për në pistë. Midis tyre, një pilot që ka qenë më parë në Formula 1 dhe dëshiron një shans të dytë, është Mick Schumacher. Emri i tij është lidhur disa herë me Alpine dhe Kick Sauber. Duket se i vetmi opsjoni i mundshëm është Sauber, ekipi më i dobët këtë sezon në Formula 1, i cili do të bëhet Audi në vitin 2026 dhe mund të krijojë një dyshe tërësisht gjermane Hulkenberg - Schumacher. Për të ardhmen e tij, djali i 7 herë kampionit të botës, Michael Schumacher, u shpreh kështu: "Do të duhet të presim dhe të shohim. Mendoj se gjithçka është shumë e hapur në Formula 1 për momentin. Janë ende tre-katër




skuadra që kanë vende në dispozicion. Mendoj se gjithçka do të mbyllët mjaft shpejt". "Shumë ekipë nuk kanë presion për të marrë një vendim tani, gjë që gjithashtu më lë pak të varur.

Gjithsesi, Formula 1 do të jetë gjithmonë prioritet në çdo gjë që bëj, kështu që derisa të mbyllët plotësisht për mua, do ta pres dhe do të fokusohem në këtë", ka shtuar Schumacher.

## Verstappen kërkon të ringjallet në shtëpinë e tij

AMSTERDAM, 22 GUSHT - Max Verstappen e ka fituar çdo Grand Prix të Holandës nga pole position qëkur gara e tij në shtëpi u kthye në kalendarin e Formulës 1 më 2021, por kampioni i trefishtë i botës i Red Bullit përballet me një provë të vështirë këtë fundjavë. Në këtë fundjavë do të zhillohet gara e radhës, por këtë herë 26-vjeçari është në serinë e tij më të gjatë të humbjeve në katër vjet. Mercedesi ka fituar tri nga katër garat e fundit dhe Verstappen, i cili kryeson me 78 pikë me 10 raunde të mbetur, nuk ka qëndruar në krye të podiumit që nga gara e zhvilluar në Spanjë më 23 qershor. Në fakt, ai ka pasur vetëm një dalje në podium që nga ajo kohë. E diela do të jetë fillimi i 200 i Verstappennit në Formula 1, duke e bërë atë pilotin më të ri që ka arritur atë moment historik. "Është gjithmonë një atmosferë fantastike dhe tifozët



janë të jashtëzakonshëm, ndaj është një atmosferë e veçantë për mua", ka thënë Vertappen, duke u deklaruar i rifreskuar dhe gati për gjysmën e dytë të sezonit pas

pushimit të gushtit. "Ne po presim me padurim javën në vijim dhe shpresojmë se mund të luftojmë për fitoren", ka shtuar Verstappen.

## Arsenali beson tek Arteta, vazhdimi i kontratës vetëm formalitet

Mikel Arteta së shpejti do ta rinovojë kontratën me Arsenalin. Marrëdhënia në mes të trajnerit, drejtorit sportiv Edu dhe pronësisë së Kroenke është aq e fortë saqë bisedimet formale nuk konsiderohen të nevojshme.

Disa takime joformale janë zhvilluar tashmë. Bisedimet kanë qenë pozitive dhe ekziston besimi se klubit do të bëhet gjithnjë e më i fortë në vitet në vijim në drejtimin e trajnerit spanjoll. Kontrata e Artetës me

Arsenalin aktualisht skadon në fund të këtij sezonin, por nuk ka asnjë nxitim nga ana e tij apo e klubit për të përfunduar një marrëveshje të re pasi ka përafrim total në vizion. Pra, asnjë presion për t'i detyruar

negociatat, të cilat ndoshta do të përfundojnë kur të përfundojë mercato. Arteta ka thënë se zgjatja e kontratës do të ndodhë në një mënyrë "natyrore". Vëmendja e tij dhe e drejtorit sportiv Edu për momentin është

kompletimi i skuadrës për të siguruar një fillim të mbarë të sezonit. Mes palëve ka qetësi maksimale dhe nuk ka nxitëm për procesin kontraktor, i cili sigrusht do të përfundojë në javët në vijim.

## SHKURT

### Dybala, afër transferimit në Arabinë Saudite

AS Roma i ka thënë zyrtarisht lamtumirë Paulo Dybalas, i cili pritet të kalojë tek arabët e Al-Qadsiah. Këta të fundit janë gati t'i ofrojnë një kontratë shumë të pasur trevjeçare me vlerë 75 milionë euro në total. "Verdhekuqtë" në listë kanë plot emra që shihen si zëvendësues të Dybalas: Jeremie Boga, Domenico Berardi, Cyril Ngonge, Federico Chiesa dhe Edon Zhegrovë.

### AstonVilla 'blindon' portierin Martinez

Porta e Aston Villas do të mbrohet nga Emiliano Martinez për pesë vitet e ardhshme. Klubi anglez ka njoftuar zgjatjen e bashkëpunimit me kampionin e botës. Argjentinasi është pjesë e Aston Villas nga viti 2020, ku u bashkua nga Arsenali për 17 milionë euro. Nga ajo kohë, Martinezi numëron 160 ndeshje me fanellën e skuadrës nga Birminghami, ndërsa e ka mbajtur portën të paprekur në 54 raste. Kontrata e tij aktuale skadonte në vitin 2027, por palët kanë rënë dakord për ta zgjatur atë deri në verën e vittit 2029.

### Felixi pas transferimit te Chelsea: Gjithmonë kam dashur të rikthehem këtu

Joao Felix u rikthyte te Chelsea pas negociatave të stërvizjatura me Atletico Madridin. Sulmuesi portugez edhe më parë ka veshur fanellën e gjigantit anglez, ku nga janari i vittit 2023 qëndroi për gjashtë muaj në "Stamford Bridge". Felix është shprehur shumë i lumtur që është rikthyer në Londër, pasi këtë e kishte në mendje që nga viti i kaluar. "Jam shumë i lumtur që jam kthyer te Chelsea dhe mezi pres të filloj. Mund të shoh disa fytyra të njohura nga hera e fundit që isha këtu, gjë që është gjithmonë e bukur dhe u thashë miqve dhe familjes se do të doja të kthehesha në Ligën Premierë një ditë", ka thënë Felix. "Ta bësh këtë me Chelsean është një ndjenjë e mrekullueshme dhe jam i emocionuar që jam rikthyer. Tani dua të fitoj me klubin tim të ri", ka shtuar Felix.

### Kalulu largohet nga Milani, paraqitet te Juventusi

Pierre Kalulu është zyrtarisht një futbollist i Juventusit. Mbrotjesi francez i dha fund papritur aventurës së tij te Milani, duke u transferuar te rivalët e kuqezinjve. Pasi kaloi me sukses vizitat mjekësore me bardhezinjtë, ai më pas u prezantua dhe menjëherë do të bashkohet me skuadrën e Thiago Mottës. Juventusi e huazoi atë me të drejtën e blerjes vigin tjetër, teksha tashmë duket se "Zonja e Vjetër" e mbylli me merkaton e saj, ku do të përqendrohet për ta rikthyer titullin kampion të Serisë A në Torino.

**KOMPANIJA REGIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË**

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të Bordit të datës 06.08.2024 për shpaljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për pëtoshimin e vendit të punës me kohë të pacaktuar, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 23.08.2024 të shpall:

**KONKURS**

Një (1) Zyrtar/e përmarrës me publikun dhe me media (zëdhënës i/e Kompanisë)- në Mitrovicë, me kohë të pacaktuar Numri i referencës: 06-08-52  
Përgatitura profesionale: Fakulteti i Gazetarisë  
Lartësia e pagës mëiore: 450.00 € Bruto

**Detyrat dhe përgjegjësia:**

- Përpilon programin e komunikimit me publikun dhe akterët ekonomik dhe social për nevojat e kompanisë dhe klientëve të saj;
- Shërben si kontakt-person përgjegjës që të informoj me kohë mediat dhe organizatat partnerë të lidhje me aktivitetet dhe rezultatet e kompanisë si dhe klientëve;
- Mbanë komunitikën të rregullt me partnerët medial ekzistues si dhe të kontribuoj aktivisht në gjetjen e kontaktave të reja me të gjithë gazetarët dhe mediat të cilët kanë përfokus apo trajtojnë çështjet ekonomike;
- Përkujdeset në mënyrë kreative përimazhin e kompanisë;
- Monitoron në baza të rregullta mediat, dhe në përputhje me rethamat të asistoj, propozoj, koordinoj dhe organizoj aktivitetet e tyre avokuese dhe paraqitet në media;
- Publikon në baza të rregullta të gjitha informacionet e ndërlidhura me kompaninë dhe klientët në ueb-faqë si dhe i menaxhon mediat sociale;
- Kryen detyra të tjera sipas kërkesave të Kryeshef Ekzekutiv;

**Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:**

Eksperiencë në bashkpunim me institucionet publike apo qeveritare si dhe me akterët të shoqërisë civile; I/e aftë të mbajë iminat konfidenciale në mënyrë të përshtatshme; Shkaktimi i komunikimit, planifikimi të punës dhe bashkpunim në ekip; Gatishmëri për punë jashtë orarit.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit. Të punësuarit punësohen për punë më orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësish nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do ti vazhdohet përvirihet kontrata e punës.

Procesi i vlerësimit përbëhet nga fazë: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe ne bazë të vlerësimit të testim me shkrirët me intervistës me gojë.

Kandidatët fitues i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësish nga ajo se a është parashtuar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë ne çdo fazë të procedurës se rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njejtë të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

**Aplikacionit i duhet bashkangjitur:**

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti" Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë përkualifikimin shkollor (e skanuar),
- CV-ja
- Kopja e letërmjekimit,
- Certifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e certifikatës/ekstratit të lindjes.

**Afat e mënyra e Aplikimit:**

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendare nga dita e publikimit të tij nejtit në gazeta diiore, dhe atë nga data 23.08.2024 deri me 06.09.2024, ora 16:00.

Kandidatët e interesuar, familjarët për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të KRM "Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr. "Vellëzrit Dragaj" p.n., qdo ditë punc nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpalje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: [krmuniteti@yahoo.com](mailto:krmuniteti@yahoo.com)

Vërejje: Aplikacionet e dorëzuar pas afatit të paraparë nuk pranohen.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRISHTINË



C.nr.3116/2012

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Valentina Sopjani, në çështjen juridike të paditësit Ismail Haxholli, të cilën e përfaqësojnë avokatet Ekrem Agushi dhe Selman Bogiqi nga Prishtina, kundër të paditurve Milladinoviq Millosav Jovanovic nga fshati Orlloviq, tani me adresë të panjohur dhe Halit Sylë Sylejmani nga Prishtina, me objekt kontesti, vërtetimin e pronësisë, duke vendosur lidhur me propozimin e paditësit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, jashtë seancës gjyqësore me datë 07.08.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Të paditurit Milladinoviq Millosav Jovanovic nga fshati Orlloviq, tani me vendbanim të panjohur, i caktuet përfaqësuesi i përkohshëm Arbëri Gegaj avokat nga Prishtina, me adresë në Rrugën "Ali Sokoli", Bll 2, lam 34, Nr.07, i cili ka për obligim që të paditurin në fjalë ta përfaqësoj në procedurën civile në lëndën që udhëhiqet me shenjën C.nr.3116/2012

II. Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

III. Ky aktvendim do të shpallet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në tabelën e shpaljeve të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësi Ismail Haxholli nga fshati Orlloviq, ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 27.11.2012, kundër të paditurit të paditurve Milladinoviq Millosav Jovanovic nga fshati Orlloviq, tani me adresë të panjohur dhe Halit Sylë Sylejmani nga Prishtina, me objekt kontesti vërtetimin e pronësisë.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Xheladin Zeneli B.I. Blin Market, me seli në Kaçanik, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811973868 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpaljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti Xheladin Zeneli B.I. Blin Market, Kaçanik donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811973868 ujedno imenova LIkvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited Xheladin Zeneli B.I. Blin Market with headquarters Kaçanik, has come to the decision to quit its business: 811973868 the company has appointet a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Nenin 7, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me operatorin "Relux" Sh.p.k. për Leje Mjedisore të Integruar, Ndryshim në impiant, fabrikë për prodhimin e ngjyrave, llaqeve, gjetit, ngjitesave, fasadave, Llapllasellë, Graçanicë, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK****Për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar**

Njoftohet publiku i interesuar se më datë: 11.09.2024, në ora: 10:00, në hapësirat e kompanisë "Relux" SH.P.K., me adersë në Magjistralen Prishtinë-Ferizaj km 6, Llapllasellë, do të organizohet debat publik nga operatori "Relux" Sh.p.k. për Leje Mjedisore të Integruar, Ndryshim në impiant, fabrikë për prodhimin e ngjyrave, llaqeve, gjetit, ngjitesave, fasadave, Llapllasellë, Graçanicë.

Debati publik do të organizohet për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar.

Me respekt,  
Ramiz Gashi  
Drejtës i menaxhues



**MEKA**  
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA  
1992





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fludi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

